

VENDIM
Nr.634, datë 24.12.1999

PËR PËRBALLIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA SHIRAT E MUAJIT NËNTOR
1999

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 8, të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999" me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 4 (katër) milionë lekë, për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga shirat e muajit nëntor 1999, në objektet si vijon:

Rethi i Lushnjës

-Kanali i ujërave të larta, Golem 2.0 milionë lekë

Rrethi i Fierit

-Kanali i ujërave të larta Levan, Fier 2.0 milionë lekë

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave

2.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta